



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
REKTORI

Nr. 2944 Prot.

Tiranë, më 29.09.2023

UDHËZIM

Nr. 3 datë 29.09.2023

PËR

“APLIKIMIN DHE REGJISTRIMIN E KANDIDATËVE NË KUOTAT E PAPLOTËSUARA PËR PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË DHE TË INTEGRUAR TË CIKLIT TË DYTË, RAUNDI III, NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË, VITI AKADEMIK 2023-2024”

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë...”, Udhëzimit të MAS nr. 12, datë 30.06.2023 “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit...”, si dhe Urdhrit të Përbashkët të RASH dhe QSHA nr.10, datë 10.07.2023 “Për miratimin e kalendarit...”, lidhur me procesin e aplikimit dhe regjistrimit në kuadër të plotësimit të kuotave të mbetura bosh në programet e studimit të ciklit të parë dhe të integruar të ciklit të dytë, Raundi III,

UDHËZOJ:

1. Kandidatët që janë pjesë e portalit U-Albania dhe që rezultojnë të pa regjistruar në një program studimi, të paraqesin pranë sekretarive mësimore të njësive kryesore (fakultetit) përkatëse kërkesën me shkrim për aplikim në atë program studimi (sipas modelit të shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij Udhëzimi), në datat **4 dhe 5 tetor 2023**, nga ora **8:00** deri në **14:00**.
2. Njësitë kryesore brenda datës **6 tetor 2023**, përcjellin në Rektorat listat e kandidatëve sipas renditjes. Publikimi i listave bëhet me datë **6 tetor 2023** në faqen zyrtare të njësive kryesore përkatëse dhe të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
3. Me datë **9 dhe 10 tetor 2023**, bëhet regjistrimi i kandidatëve sipas renditjes së shpallur në pikën 2, pranë njësive kryesore në përputhje me kuotat e mbetura bosh, **me minifaza 2 orëshe**, si më poshtë:

Data 9 tetor 2023

Faza I – ora 9.⁰⁰-11.⁰⁰

Faza II – ora 11.⁰¹-13.⁰⁰

Faza III- ora 13.⁰¹-15.⁰⁰

Data 10 tetor 2023

Faza I – ora 9.⁰⁰-11.⁰⁰

Faza II – ora 11.⁰¹-13.⁰⁰

Faza III- ora 13.⁰¹-15.⁰⁰

4. Kandidati fitues ka të drejtë të **regjistrohet brenda minifazës 2 orëshe**, në të kundërt vendi fitues i kalon kandidatëve në pritje sipas listës së renditur.
5. Njësitë kryesore përcjellin në Rektorat listat e kandidatëve të regjistruar brenda datës **11 tetor 2023**.
6. Të gjithë aplikantët sipas pikës 2 dhe 4 së bashku me modelin sipas shtojcës 1, të bashkëlidhin kopje të ID, të diplomës së Maturës Shtetërore si dhe listën e notave të gjitha viteve të shkollës së mesme.
7. Për zbatimin e këtij Udhëzimi ngarkohen njësitë kryesore të UMT-së dhe sekretaritet mësimore.



Shtojca nr. 1

FORMULAR KËRKESE

Unë i nënshkruari _____, ID e maturës _____, aplikant pjesë e portalit U-Albania, paraqes kërkesën time për të vijuar konkurrimin në programin e studimit _____.

- Deklaroj se nuk jam regjistruar në asnjë program tjetër studimi.
- Jam informuar nëpërmjet faqes zyrtare të njësisë kryesore (fakultetit) dhe universitetit, për Udhëzimin e Rektorit të UMT-së nr. _____, datë _____.2023 *"Për aplikimin dhe regjistrimin e kandidatëve në kuotat e paplotësuara..."*, lidhur me publikimin e renditjes dhe fazat e regjistrimit të kandidatëve.

Emër

Atësi

Mbiemër

Nr. telefoni: